



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok.202000020/6

Tiranë ___/___/2020

Lënda: *Rekomandim për marrjen e masave për rishikimin e dosjes së dëmshpërblimit nr.***** të ish të dënuarit politik H.K, duke rivlerësuar trashëgimtarët dhe mënyrën e dhënies së kësteve për znj.B.S në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.*

Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Z.Oltjon MUZAKA

Tiranë

I nderuar zoti Muzaka,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit është depozituar ankesa e znj.B.S në të cilën shpjegon vonesën për dhënien e kështit të tretë të dëmshpërblimit si trashëgimtare e ish të dënuarit Z.S (bashkëshorti i ndjerë i znj.B.S) me dosje nr.**** miratuar me VKM nr.363, datë 05.05.2011 dhe problematikën e hasur për akordimin e kësteve në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë lidhur me dosjen e ish të dënuarit H.K (vëllai i ndjerë i znj.B.S) nr.*****, miratuar me VKM nr.497, datë 01.08.2012.

Nga ana jonë, është kërkuar informacion në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ku kemi parashtruar ndër të tjera moshën e thyer dhe kushtet e vështira ekonomike në të cilat gjendet ankuesja.

Në përgjigjen e ardhur nga ana juaj nr.3278/1 prot., datë 20.02.2019, referohet se dëmshpërblimi financiar që i përket ish të dënuarit politik z.Z.S me nr.dosjeje **** miratuar me VKM nr.363, datë 04.05.2011 me vlerë totale të dëmshpërblimit prej 1 810 734 lekë, rezulton se ka përfituar kështin e parë të dëmshpërblimit financiar në vitin 2012.

Dëshpërblimi financiar i ish të dënuarit politik z.H.K me nr.dosjeje ***** miratuar me VKM nr.497, datë 01.08.2012, me vlerë totale të dëmshpërblimit financiar prej 9 534 055 lekë, ka përfituar kështin e parë të dëmshpërblimit financiar në vitin 2013.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar, si dhe VKM-së nr.419, datë 14.04.2011 “Për miratimin e afateve dhe skemës së shpërndarjes së fondeve të dëmshpërblimit për ish të dënuarit politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar ka çelur këstin e radhës për kategorinë e trashëgimtarëve (këstin e tretë) në datë 22.10.2018.

Në zbatim të Udhëzimit nr.5, datë 15.04.2016, Drejtoria e Pagesave dhe Dëmshpërblimeve, kryen shpërndarjen e dëmshpërblimit të këstit të radhës, duke ndjekur radhën e pagesës së këstit të parë.

Aktualisht, Drejtoria e Pagesave dhe Dëmshpërblimeve po shqyrton dosjet për këst të tretë, trashëgimtarët e të cilëve kanë përfituar këstin e parë në vitin 2010-2011 dhe dosjet nr.8763 dhe nr.19555 nuk janë ende në radhë pagese për përfitimin e këstit të tretë.

Sipas udhëzimit nr.273/1, datë 27.08.2012, përfitojnë dhënie përparësie për pagesën e dëmshpërblimit financiar ish të dënuarit politikë të cilët:

- Nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për punë (KMCA) janë vlerësuar me humbje të plotë të aftësisë për punë.
- Vuajnë nga sëmundje malinje onkologjike ose hematologjike (sëmundje gjaku) të trajtuara nga spitalet universitare shtetërore.

Nga verifikimet e dokumenteve ligjorë, znj.S nuk përfshihet në rastet e përcaktuara më lart për dhënien e përparësisë.

Nga ana jonë është dërguar kërkesë e përsëritur për shpjegime nëpërmjet shkresës nr.K2/B-1/4, datë 01.06.2020, lidhur me dosjen nr.***** të ish të dënuarit politik z.H.K, konkretisht referuar shpërndarjes së kësteve dhe përfitimit të znj. Q.K. Njëkohësisht duhet theksuar se parashikimi i nenit 8 të ligjit: “Në rastin kur e drejta e përfitimit të dëmshpërblimit financiar përfundon me mbylljen e rrethit të familjarëve që nuk jetojnë, të përcaktuar sipas pikës 1, të këtij neni, dëmshpërblimi financiar, për pjesën takuese të tyre, kalon në buxhetin e shtetit”, është një përcaktim që është bërë me ndryshimet e vitit 2018 në ligj, konkretisht me ligjin nr.57/2018.

Me shkresën tuaj nr.10981, datë 12.06.2020 drejtuar institucionit tonë, referoni se me shkresën nr.16808, datë 19.09.2019, drejtuar znj.B.S, ju keni informuar të interesuarën në mënyrë shteruese në lidhje me arsyen se përse ajo nuk ka përfituar këstin e dytë të dëmshpërblimit financiar për ish të dënuarin politik z.H.K.

Drejtoria e Pagesave dhe Dëmshpërblimeve, ka shqyrtuar dosjen nr.***** për përfitimin e këstit të dytë në vitin 2016 dhe sipas dokumenteve ligjorë në dosje, u konstatua se shpërndarja e këstit të parë në vitin 2013 nuk ishte kryer në përputhje me dokumentet e depozituara nga ana e subjekteve përfituese dhe kuadrit ligjor në fuqi. Shpërndarja e këstit të parë është kryer me 1/6 pjesë, duke përjashtuar në këtë mënyrë nga dëmshpërblimi financiar bashkëshorten e ish të dënuarit politik znj.Q.K e cila, sipas vendimit nr.170, datë 18.01.2013, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfiton 1/2 pjesë të trashëgimisë ligjore të tij dhe pjesa tjetër prej 1/2 shpërndahet midis vëllezërve e motrave të tij.

Për këtë arsye, duke qenë se trashëgimtarët ligjorë të ish të përndjekurit politik z.K., (vëllai, motra, nipat e mbesat që kanë përfitur me zëvendësim) kanë përfitur pa të drejtë edhe ½ pjesë të përcaktuar nga gjykata bashkëshortes së tij znj.Q.K, në sistemin elektronik të kryerjes së pagesave vlera monetare e kështit të dytë i përlllogaritet këtyre të fundit e barabartë me zero lekë, me qëllim sistemimin e kështit të parë të përfitur pa të drejtë më tepër.

Drejtoria e Pagesave dhe Dëmshpërblimeve për të përcaktuar familjarët e ish të dënuarve politikë që nuk jetojnë, mbështetet në vendimet gjyqësore të formës së prerë për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për ish të dënuarit politikë. Konkretisht vendimi nr.170, datë 18.01.2013, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka përcaktuar qartë rrethin familjar të cilët përfitojnë nga trashëgimia ligjore e trashëgimlënësit H.K, si dhe masën e përfitimit të kësaj trashëgimie për secilin përfitues.

Sipas vendimit nr.5843, datë 30.10.2006, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, trashëgimtar ligjor i znj.Q.K është përcaktuar nipi i saj i cili, referuar nenit 8 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 *“Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”*, të ndryshuar, është jashtë rrethit familjar të ish të dënuarit politik dhe nuk mund të përfitojë dëmshpërblimin financiar për pjesën takuese të znj.Q.K.

Sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë dokumentet ligjorë në dosje, Drejtoria e Pagesave dhe Dëmshpërblimeve ka regjistruar në sistemin elektronik të pagesave të ish të dënuarve politikë edhe subjektin përfitues znj.Q.K, në cilësinë e bashkëshortes së ish të dënuarit politik, si trashëgimtare e radhës së parë. Për rrjedhojë, sistemi elektronik bën korrigjimin e shumës së kështit të parë, duke e vlerësuar kështin e dytë të barabartë me zero lekë.

Me kërkesën e parashtruar nga znj. S, rezultoi se znj.Q.K nuk jeton, ndaj edhe Drejtoria e Pagesave dhe Dëmshpërblimeve me shkresën nr.16808 prot., datë 19.09.2019, e ka informuar se në këto kushte, referuar nenit 8 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 *“Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”*, të ndryshuar: *“Në rastin kur e drejta e përfitimit të dëmshpërblimit financiar përfundon me mbylljen e rrethit të familjarëve që nuk jetojnë, të përcaktuar sipas pikës 1, të këtij neni, dëmshpërblimi financiar, për pjesën takuese të tyre, kalon në buxhetin e shtetit.”* Pra duke filluar nga kësti i tretë e në vijim, pjesa takuese financiare e znj.Q.K do të kalojë në favor të shtetit.

Pra, konkludojmë që në asnjë rast nuk është dhënë fuqi prapavepruese ligjit, sikundër ju shpreheni në kërkesën tuaj. Drejtoria e Pagesave dhe Dëmshpërblimeve, brenda fushës së saj së përgjegjësisë ka zbatuar vendimin nr.170, datë 18.01.2013, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në përputhje me nenin 8 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 *“Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”*, të ndryshuar.

Nga ana jonë, vlerësohet se sipas vendimit gjyqësor nr.170, datë 18.01.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësit e shtetasit H.K, i cili ka vdekur në datë 19.04.1990 vërtetuar kjo me certifikatën përkatëse të vdekjes. Në këtë vendim është përcaktuar se ndër trashëgimtarët e shtetasit H.K është edhe bashkëshortja e tij, Q.K me të cilën ky shtetas nuk ka fëmijë.

Nga ana tjetër, me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor nr.5843, datë 30.10.2006 është lëshuar dëshmia e trashëgimisë testamentare në emër të trashëgimlënëses Q.K e cila ka vdekur në datë 11.08.2006 e vërtetuar kjo me certifikatën e vdekjes përkatëse.

Trashëgimtari testamentar është A.Z i nipi, por që është jashtë rrethit familjar të ish të dënuarit politik dhe nuk mund të përfitojë dëmshpërblimin financiar.

Dosja e ish të dënuarit H.K është miratuar me nr.*****, nëpërmjet VKM-së nr.497, datë 01.08.2012. Kësti i parë i dëmshpërblimit financiar është akorduar në vitin 2013. E evidentojmë këtë fakt sepse në këtë vit si ish i dënuari, po ashtu edhe bashkëshortja kishin vdekur.

Ligji nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar, përpara ndryshimeve të vitit 2018 sanksiononte shprehimisht: “1. Në kuptim të këtij ligji, me familjarë nënkuptohen, pavarësisht nga rregullime të tjera ligjore, paraardhësit, bashkëshortja, pasardhësit, vëllezërit dhe motrat e ish të dënuarit politik, si dhe fëmija/fëmijët e vëllezërve dhe motrave. 2. Familjarët, në shkallë më të parë, sipas Kodit Civil, përjashtojnë familjarët e tjerë.”

Kështu në vitin 2013, kur është bërë shpërndarja e këstit të parë për trashëgimtarët nuk ka si të përfitojë bashkëshortja e ish të dënuarit, Q.K, e cila ka vdekur në vitin 2006 dhe nuk ka pasur fëmijë me ish të dënuarin. Në frymën e ligjit dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, kjo pjesë ndahet midis trashëgimtarëve të tjerë përfitues.

Vetëm nëpërmjet ndryshimeve të pësura me ligjin nr.57/2018, date 13.09.2018 në nenin 8 është shtuar pika 3 me përmbajtjen:

“3. Në rastin kur e drejta e përfitimit të dëmshpërblimit financiar përfundon me mbylljen e rrethit të familjarëve që nuk jetojnë, të përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni, dëmshpërblimi financiar, për pjesën takuese të tyre, kalon në buxhetin e shtetit.”

Dëshirojmë të evidentojmë faktin se institucioni i Avokatit të Popullit i ka kushtuar vëmendje të veçantë trajtimit me prioritet të rasteve për përfitimin e dëmshpërblimit për ish të dënuarit politikë.

Nuk duhet harruar se edhe pse kanë kaluar 30 vjet nga shembja e sistemit komunist në Shqipëri, shoqëria shqiptare është ende e ndjeshme ndaj kësaj periudhe të errët në historinë e saj. Regjimi komunist për gati gjysmë shekulli ka shkaktuar një numër të madh të viktimave në shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe në shkelje të rënda të ligjit ndërkombëtar humanitar.

Gjendja sociale në të cilën ata gjenden sot, nuk është një gjendje për t'u marrë si model, por një gjendje varfërie. Ndër të tjera, si edhe shihet mosha e thyer e ish- të përndjekurve është e tillë që nuk mundëson pritjen e gjatë për të marrë dëmshpërblimin. Ka mjaft probleme tek shtresa e ish-të përndjekurve politikë, pavarësisht përpjekjeve të herëpashershme të strukturave shtetërore për integrimin e shtresës së ish të përndjekurve.

Në ditët e sotme, ish të dënuarit politikë të regjimit komunist përfaqësojnë një nga shtresat shoqërore, e cila ende nuk ka përfituar plotësisht të drejtat e saj, pavarësisht hapave të ndërmarrë nga shteti për t'i adresuar ato. Në vitin 2007, u miratua ligji nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, në zbatim të të cilit janë nxjerrë edhe akte nënligjore, me qëllim miratimin e skemës së shpërndarjes për kompensimin e ish të dënuarve politikë të komunizmit.

Por, vihet re se procesi i kompensimit më shumë është vështirësuar dhe nuk ka përparuar me normat e dëshiruara, për arsye që lidhen kryesisht me ndryshimet që ka pësuar legjislacioni përgjatë viteve dhe mospërcaktimin e një afati të arsyeshëm për përfundimin e tij.

Shteti shqiptar përmes rivendosjes së një shoqërie të lirë dhe demokratike, ka marrë përsipër angazhimin për krijimin e një sistemi ligjor në mbrojtje të të drejtave themelore të njeriut, ku shtetasve shqiptarë t'u jepet garancia e ushtrimit të këtyre të drejtave. Gjithashtu, këto të drejta duhet të njihen dhe realizohen nga shteti, brenda një afati të arsyeshëm, për të bërë të mundur përfitimin, në rastin konkret të dëmshpërblimeve.

Për gjithë sa parashtruam, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe të lirive nga administrata publike”*, si dhe në ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, neni 21/b në të cilin parashikohet: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*:

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave për rishikimin e dosjes së dëmshpërblimit nr.***** të ish të dënuarit politik H.K, duke rivlerësuar trashëgimtarët dhe mënyrën e dhënies së kësteve për znj.B.S në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar lutemi na vini në dijeni për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi